

VENDIM
Nr. 41, datë 21.1.2026

**PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
EKONOMISË MALORE NË BASHKINË MEMALIAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Memaliaj të zonave, si më poshtë vijon:

a) Zona zhvillimore nr. 1, që përfshin territore nga fshatrat Arrëz e Madhe, Maricaj dhe Vagalat, pjesë e njësisë administrative Luftinjë, me sipërfaqe 1 152.01 ha (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e dy pikë zero një) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

b) Zona zhvillimore nr. 2, njësia administrative Buz, me sipërfaqe 5 916.22 ha (pesë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë njëzet e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto;

c) Zona zhvillimore nr. 3, fshati Rabie, pjesë e njësisë administrative Luftinjë, me sipërfaqe 1 241.43 ha (një mijë e dyqind e dyzet e një pikë dyzet e tre) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë zonë janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Memaliaj për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN –VENDOSJA E ZONES ZHVILLIMORE NJESIA ADMINISTRATIVE BUZ SH-1:100000
SIPERFAQJA=5916.22HA

KOORDINATAT

PIKA	X	Y
1-	497054	4484434
2-	497866	4484854
3-	499070	4484462
4-	501422	4482754
5	503830	4482166
6-	505034	4479478
7-	504222	4476510
8-	500386	4474886
9-	497278	4477658
10-	495654	4481634
11-	496550	4483202



PLAN –VENDOSJA E ZONES ZHVILLIMORE NJESIA ADMINISTRATIVE LUFTINJE S H-1:50000
FSHATRA: ARREZ E MADHE , MARICAJ,VAGALAT
SIPERFAQJA=1152.01HA

KOORDINATAT

PIKA	X	Y
1-	503360	4473503
2-	503346	4474385
3-	503850	4474609
4-	504200	4474245
5	504746	4474413
6-	504886	4476163
7-	504872	4476163
8-	504998	4476821
9-	505614	4476261
10-	506160	4471977
11-	505362	4470437
12-	503962	4470031



SIPERFAQJA=1241.43HA

KOORDINATAT

[illegible]